



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:252516

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06734190

KPPP.nr. 1409/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovës me seli në Prishtinë, kundër debitorit “KEK” Sh.A., me nr. unik identifikues 811290808 dhe me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 644/24 të datës 02.08.2024, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati me zyre në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 21.01.2025 merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “KEK” Sh.A., ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 644/24 i datës 02.08.2024, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Inspektorati i Punës në Kosovë, me datë 02.08.2024 ka lëshuar urdhrin P.nr. 644/24 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit - Aktvendim nr. 01/08-10-2024-B të datës 12.02.2024, ashtu që është detyruar debitori “KEK” Sh.A., që në emër të gjobës administrative të shqiptuar sipas aktvendimit të lartcekur t’ia paguaj kreditorit t’ia paguaj shumën e borxhit prej 500.00 EUR, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor përmes të së cilit ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbartimit me arsyetimin se propozimi për përmbartim është i parakohshëm, kjo për faktin se kreditori nuk i është drejtuar asnjëherë debitorit që ta përmbush vullnetarisht detyrimin. Tutje ka shtuar se debitori, ka paraqitur padi për anulimin e dokumentit

mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi pranë Gjykatës Komerciale – Departamenti për Çështje Administrative andaj këto arsye, paraqesin shkaqe të mjaftueshme që prapësimi i debitorit të pranohet ndërsa urdhri për lejimin e përmbartimit të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje ndaj prapësimi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbartues ka lejuar përmbartimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbartimor, përkatësisht Vendimin nr. 01/08-10-2024-B të datës 12.02.2024 në bazë të së cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin dhe gjeti se i njëjti, konform nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbartues sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla dhe po ashtu i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata tutje konstatoi se Aktvendimi nr. nr. 01/08-10-2024-B të datës 12.02.2024 i plotëson kushtet e përcaktuara edhe në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmëris për përmbartueshmëri”,* ngase i njëjti është i pajisur me klauzolën e përmbartueshmërisë, nga e cila rezulton se vendimi është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me datë 18.04.2024.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit lidhur me mungesën e ligjshmërisë së dokumentit përmbartues mirëpo gjeti se këto pretendime, nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës

përmbartimore ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22 dhe 27 të LPP-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1409/24 datë 21.01.2025

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.